



PËRKUJDESJA NDAJ MOSHËS SË TRETË

Skënder Dule
Frank Hantke
Sabine Hartig
Elena Pici



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



PËRKUJDESJA NDAJ MOSHËS SË TRETË



Tiranë, Nëntor 2014

Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung
Office Tirana
Rr. Abdi Toptani
Torre Drin, Kati i 3-te
Kutia Postare 1418
Tirane, Albania

Autorë: Skender Dule
Frank Hantke
Sabine Hartig
Elena Pici

Redaktoi: Elena Pici

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Përmbatja

Parathënie: Përse ky Kongres?	4
Shënim i organizatorëve	6
Z. Frank Hantke	
Znj. Sabine Hartig	
Letër përshëndetëse e DVBA	12
Axhendë	14
Prezantim: Situata aktuale e përkujdesjes ndaj moshës së tretë në Shqipëri	16
Prezantim: Shqipëria si ofruese e shërbimit të përkujdesjes ndaj moshës së tretë	21
Konkluzione	23
Memorandum	26
Foto të Kongresit	28

Parathënie: Përse ky Kongres?

Skënder Dule

Kryetar i Shoqatës “SANUS Infermieri Ambulante”



Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të bëjnë një jetë të gjatë dhe vitale. Në të vërtetë në Shqipëri jetëgjatësia po rritet në vazhdimësi. Gjithashtu, ka gjithnjë e më shumë njerëz të cilët jetojnë gjatë pa ankesa dhe probleme, megjithëse me rritjen e moshës u shtohet gjithnjë e më shumë edhe rreziku i sëmundjeve. Dalja në pension, braktisja nga fëmijët apo dhe mungesa e aktivitetit fizik e social bën që shumë nga të moshuarit të përballen fuqishëm me depresionin dhe pasojat e tij.

Por ç’ndodh në të vërtetë me këtë kategori sociale në Shqipëri?

Kjo pyetje ishte bërë prej kohësh tema kryesore e diskutimeve në Shoqatën profesionale “SANUS Infermieri Ambulante”. Gjithashtu dhe ideja për një takim kombëtar të aktorëve dhe faktorëve në fushën e përkujdesjes për të moshuarit me qëllim shkëmbim e mendimeve, përvojave të deritanishme dhe gjetjen e zgjidhjeve për të ardhmen. E gjithë kjo do të finalizohet më pas në kongresin e parë kombëtar si produkt i bashkëpunimit me organizatën gjermane GIZ dhe mbështetjes organizative dhe financiare të fondacionit Friedrich Ebert Stiftung (FES)

Megjithë përpjekjet e vazhdueshëm në kuadër të formimit profesional në fushën e përkujdesjes për të moshuar dhe ndërmjetsimit në treg (për të cilën shoqata “SANUS Infermieri Ambulante” është tashmë e licensuar), një arsye shumë e fortë për thirrjen e kongresit ishte edhe evidentimi i nevojës për njohjen zyrtare të profesionit të kujdestarit për të moshuar me një kualifikim të përshtatshëm sipas standardeve europiane në funksion të rritjes së cilësisë së kujdesit ndaj të moshuarve, por dhe të jetëgjatësisë së shoqërisë në përgjithësi.

Gjithmonë e më shumë sot po bëhet e domosdoshme të rritet interesimi i shoqërisë për të moshuarit. Ashtu si dhe fëmijët, edhe të moshuarit kanë nevojë për një shërbim në struktura multidisiplinare geriatrike të specializuara. Pra, krijimi i një rrjeti profesional bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare partnere me fokus të moshuarit, ishte gjithashtu një tjetër arsye e fortë për thirrjen e këtij kongresi.

Plakja është një fenomen shumëformësh, e në qoftë se vdekja është e paevitueshme, plakja

edhe mund të parandalohet. Çdo njeri duhet të jete i kënaqur dhe sa më i pavarur si gjatë gjithë jetës tij ashtu dhe në pleqëri. Por shumë prej te drejtave dhe mundësive atyre akoma nuk u njihen. Nga ana tjetër ato nuk shfrytëzohen mjaftueshëm nga vetë të moshuarit, për këtë arsye diskutimi për të themeluar një grup gjithpërfshirës interesi do të ishte finalizimi i suksesshëm i këtij kongresi.

Pra, një shoqatë kombëtare e cila do të ishte vokacioni jo vetëm i të moshuarve por dhe i profesionistëve të kujdesit për të moshuar në institucionet përgjegjëse si dhe në shoqërinë civile.

Është sfida jonë profesionale që mbrojtja e shëndetit dhe përkujdesja sociale të luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e të moshuarve, me qëllimin që gjithnjë e më shumë njerëz të mund të plaken shëndetshëm.

Shënim i organizatorëve

Frank Hantke

Drejtor i Fondacionit Friedrich Ebert,
Zyra e Tiranës



Kujdesi për moshën e tretë: Që sot duhet të punojmë për të ardhmen dhe ta planifikojmë atë

Me Kongresin Kombëtar për Kujdesin për Moshën e Tretë, në të cilin morën pjesë pjesa më e madhe e organizatave që ofrojnë kujdestari dhe trajtim për moshën e tretë në Shqipëri, u hodh hapi i parë i rëndësishëm për të ardhmen e të moshuarve në Shqipëri. Ky takimi në Tiranë shërbeu për të krijuar një përfaqësim të fuqishëm dhe aktiv të interesave të të punësuarve në sektorin e kujdestarisë për moshën e tretë. Kjo ishte edhe arsyeja kryesore, se përse Fondacioni Friedrich Ebert e mbështeti këtë kongres. Në një shoqëri demokratike është e domosdoshme, që interesat e ndryshme të përfaqësohen në mënyrë kompetente nga organizatat përkatëse në kuadër të një diskutimi shoqëror dhe politik.

Shoqëria mban përgjegjësi për të moshuarit e saj.

Pyetja, se si po sillet shoqëria shqiptare me të moshuarit e saj, vazhdon të mos përbëjë një temë sociale dhe të mos diskutohet publikisht. Kjo duhet të ndryshojë dhe për këtë nevojitet një përfaqësim më i fuqishëm i interesave të kujdesit për moshën e tretë. Sepse në ditët e sotme mund të parashikohet, që problemet e kujdesit për moshën e tretë do të vijnë në rritje. Dhe në këtë përfundim arrihet duke marrë parasysh situatën shumë të keqe të të moshuarve në ditët e sotme. Vetëm një pjesë e vogël e këtij grupimi pranohet në shtëpitë përkatëse të të moshuarve apo merr një trajtim të mirë mjekësor. Edhe këtu konstatohet, se ekzistojnë dallime të mëdha midis të moshuarve – kush disponon para të mjaftueshme, mbase mund ta përballojë trajtimin dhe kujdesin privat, por pjesa më e madhe e të moshuarve nuk i disponon këto para të mjaftueshme dhe duhet ta kalojë pleqërinë në kushte pjesërisht të padenja për njeriun. Fjalja “Shoqëria e tregon fytyrën e saj të vërtetë në mënyrën si sillet me të moshuarit” duhet të jetë një paralajmërim dhe njëkohësisht një shtysë për ta përmirësuar shpejt situatën e sotme dhe për t’u përgatitur për të ardhmen. Kjo nuk mund dhe nuk duhet t’i lihet ekskluzivisht vetëm iniciativës private!

Për kohën me shi të përgatitemi kur shndrin dielli!

Shqipëri vazhdon të ketë ende një shoqëri me moshë të re, e cila nuk e kalon moshën mesatare të 30 vjetëve. Shkak për këtë është numri i lartë i lindjeve në fillim të viteve 90, kur Shqipëria kishte numrin më të lartë të lindjeve në Evropë. Por në ditët e sotme numri i lindjeve në vend është nga më të ulët në Evropë. Sigurisht që për arsyet mund të diskutohet gjatë. Edhe në vitet në vijim nuk pritet ndonjë ndryshim i këtyre rrethanave. Pra mbetet fakt, që shoqëria shqiptare në 20 vitet e ardhshme do të plakët me shpejtësi, sepse - për fat të mirë - edhe jetëgjatësia është rritur. Ata që në ditët e sotme nuk e pranojnë këtë zhvillim të parashikueshëm, do të jenë bashkëfajtorë për gjendjen e mjerueshme të brezit të moshuar në të ardhmen. Mund të mësohet shumë edhe nga përvoja e vendeve të tjera të Evropës – edhe nga vendet fqinje. Në shumë shtete janë zgjeruar sistemet sociale publike, në mënyrë që të mbahet parasysh plakja e shoqërisë. Edhe Shqipëria duhet të përballet me këtë diskutim.

Kujdestarët për të moshuar “të mos lihen në hije”

Në Shqipëri ende nuk ekziston profesioni i “kujdestarit për të moshuar”. Në fakt ky profesion mësohet në shkollë, për shembull në Qendrën Shumëfunktionale në Kamëz me mbështetjen e GIZ-së gjermane, dhe ofrohen edhe degë të ndryshme studimore në këtë fushë. Por sa kohë që profesioni nuk njihet, edhe personat që e kanë mësuar në shkollë profesionin e “kujdestarit për të moshuar” do të kenë pak shanse për të gjetur punë. Në këtë mënyrë nuk ekziston shtysa për ta mësuar këtë profesion të së ardhmes. Kjo duhet të ndryshojë, sepse edhe në ditët e sotme nevojiten në tregun e punës kujdestarë për të moshuar të mirëarsimuar. Shpesh për të moshuarit kujdeset – më shpesh keq sesa mirë - një personel, i cili nuk është shkolluar mjaftueshëm për ta bërë këtë punë. Të gjithë e dinë, se kujdestaria për të moshuarit ka nevojë për shumë kualifikim – duke filluar nga njohuritë mjekësore dhe deri tek kompetencat sociale. Për këtë arsye hapi i parë i rëndësishëm është, që degët mësimore ekzistuese të fuqizohen dhe të zgjerohen më tej. Edhe profesioni i kujdestarit për të moshuar duhet të njihet dhe të mbështetet. Në shtëpitë e të moshuarve dhe në institucionet e kujdestarisë duhet që në të ardhmen të ketë një numër të mjaftueshëm kujdestarësh kompetentë.

Përse të synojmë më shumë?

Gjatë kongresit lindi një debat interesant, se si në një situatë të mjeruar mund të krijohet një model i pranueshëm për të ardhmen. Ashtu si edhe vende të tjera në Evropë, të cilat e kanë kaluar periudhën e tranzicionit, edhe Shqipëria ka disa avantazhe, të cilët sinjalizojnë se kujdestaria për moshën e tretë duhet të zhvillohet aq shumë, sa madje përveç nevojave vetjake të bëhen oferta edhe për qytetarë të shteteve të tjera. Përveç kësaj Shqipëria disponon ende veçori natyrore, të cilat mund të jenë shumë të rëndësishme për shumë të moshuar në të gjithë Evropën. Me një vizion të tillë Shqipëria mund të bëjë një ofertë, e cila sigurisht do të ishte shumë interesante për njerëzit në BE. Po ky vizion i guximshëm na tregon drejtimin e duhur në ditët e sotme: njohja e profesionit, shkollim më i mirë, më i thellë, më i orientuar drejt praktikës, krijimi i shtëpive të më shumë shtëpive të mira për të moshuarit si edhe i stacioneve të kujdestarisë.

Përfaqësim i fuqishëm i interesave

Gjatë kongresit shumë pjesëmarrëse dhe pjesëmarrës spontanisht u angazhuan fuqimisht, që në të ardhmen të bashkohen në një organizatë për përfaqësimin e interesave të “kujdestarisë për të moshuar”. Ata e kanë kuptuar, se problemet e tyre profesionale në jetën e përditshme si edhe situata e keqe e të moshuarve kanë nevojë për një zë të përbashkët, i cili të përfshihet në mënyrë kompetente në diskutimin dhe planifikimin social. Kjo shoqatë e re do të krijohet gjatë muajve në vijim. Ajo do të formulojë qëllimet dhe hartojë strategjitë e saj, se si kjo temë do të mund të trajtohet publikisht me sukses. Gjatë punës së saj shoqata do të mbështetet nga Fondacioni Friedrich Ebert.



Shënim i organizatorëve

Sabine Hartig

Drejtoreshë e Programeve të Trajnimit dhe Edukimit Profesional

GIZ

Prej shtatë vjetësh Gjermania është duke e mbështetur shkollimin e kujdestareve dhe kujdestarëve për të moshuar në shkollën profesionale të Kamzës. Transformimi i shkollës në një Qendër Shumëfunksionale (QSHF) është edhe synimi kryesor i “Programit për Arsimin dhe Formimin Profesional në Shqipëri”, i cili është duke u implementuar prej vitit 2012 nga GIZ me porosi të BMZ-së së bashku me Ministrinë partnere shqiptare, Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR). Pika kryesore e këtij programi është dhënia e mbështetjes për degën e “Kujdesit Social dhe Shëndetësor”.

Pse kujdestaria për të moshuar është një fushë kaq e rëndësishme për Bashkëpunimin Gjerman?

Dy janë arsyt kryesore:

Tema e “plakjes së popullatës” do të jetë në të ardhmen e pranishme edhe në Shqipëri. Shqipëria vazhdon të ketë kryesisht ende një popullatë me moshë të re, por tashmë është shfaqur një zhvendosje e qartë në piramidën e moshës. Rezultatet e censusit të realizuar nga INSTAT-i në vitin 2011 tregojnë, se përqindja e të moshuarve në popullatë është rritur ndjeshëm për shkak të shkallës së ulët të lindjeve dhe emigrimit të lartë të të rinjve jashtë shtetit gjatë 10 viteve të fundit. Parashikohet që ky trend të mos ketë ndryshime. Në të ardhmen nevojat për kujdestari nuk do të mund të mbulohen nga familjet. Këto zhvillime kërkojnë krijimin e shpejtë në Shqipëri të një sistemi kujdestarie solid dhe në përputhje me nevojat.

Shqipëria është në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Anëtarësimi në BE lidhet me lëvizjen e lirë të punëmarrësve, dmth. me të drejtën për të punuar në një shtet tjetër të BE. Në shtetet e Evropës Qendrore, me në krye Gjermaninë, në ditët e sotme ekziston një nevojë e madhe për fuqi punëtore në fushën e kujdestarisë për të moshuar; parashikohet që në të ardhmen do të ketë shumë nevojë për kujdestarë për të moshuar. Për këtë arsye, në këtë sektor punëtorët e huaj kanë shanse shumë të mira për të gjetur një vend pune. Nëse punëtorët shqiptarë do të ktheheshin në vendin e tyre pas disa vitesh pune në Evropë,

ky do të ishte një shans i madh dhe rritje vlerash për Shqipërinë, sepse në këtë mënyrë në vend do të sillen dhe zbatohen standardet evropiane.

Kujdestaria sot

Në ditë e sotme në Shqipëri nuk ofrohet një trajtim i pranueshëm mjekësor dhe social për të gjithë të moshuarit. Shkollimi i infermiereve dhe infermierëve, i cili përfundon me marrjen e diplomës akademike, nuk i tematizon mjaftueshëm sëmundjet dhe nevojat specifike të të gjithë të moshuarve. Kërkesat specifike për një kujdestari të përshtatshme për moshën e tretë nuk merren në konsideratë. Aktualisht punonjësit që punojnë në institucionet e kujdestarisë për të moshuar – përveç infermiereve dhe infermierëve që punojnë atje – nuk duhet të kenë mbaruar formimin profesional përkatës. Kushti kryesor për punësimin e tyre është përfundimi i maturës. Kjo çon në një trajtim të pamjaftueshëm për të moshuarit. Trajtimet e gabuara deri edhe keqtrajtimet e të moshuarve në shtëpitë e të moshuarve janë një temë që përsëritet herë pas here.

Shkollimi i kujdestareve dhe kujdestarëve për të moshuar në QSHF Kamëz

QSHF Kamëz nuk është vetëm shkolla e vetme publike, por madje edhe shkolla e vetme profesionale në Shqipëri, e cila ofron shkollimin e kujdestarëve për të moshuar. Pas shkollimit 4-vjeçar nxënësit e shkollës pajisen nga njëra anë me certifikatë profesionale dhe nga ana tjetër me diplomën e maturës. Në mënyrë që nxënëset dhe nxënësit të përgatiten sa më mirë për profesionin është parashikuar një numër i lartë orë mësimore praktike. Deri dy ditë në javë nxënësit kujdesen për të moshuarit në shtëpitë e të moshuarve rezidenciale apo ditore. Aktualisht kurrikula mësimore është duke u ndryshuar dhe në të ardhmen parashikohet që të paktën 50 % e orëve mësimore të jenë mësim praktik. Qëllimi i ndryshimit të kurrikulës është që formimi profesional për kujdestarët për të moshuar në Shqipëri të jetë i barazvlefshëm me formimin profesional të një ndihmëskujdestari për të moshuar në Gjermani dhe në këtë mënyrë përafrohen standardet e arsimit profesional me Gjermaninë/Evropën.

Bashkëpunimi midis QSHF Kamëz dhe institucioneve të kujdestarisë në rajonin Kamëz-Tiranë është një histori suksesi. Institucionet janë shumë të angazhuara që t'i ndihmojnë nxënësit në punën e përditshme. Njëkohësisht ata e vlerësojnë aktivizimin e nxënësve dhe kontributin e tyre në trajtimin e të moshuarve. Por bashkëpunimi nuk do të kishte qenë i mundur, nëse drejtoria e QSHF Kamëz dhe Departamenti i Kujdesit Social dhe Shëndetësor në shkollë – drejtuesi dhe mësuesit e tij – nuk do të jepnin më të mirën e tyre për ta bërë të suksesshëm shkollimin.

E ardhmja e profesionit të kujdestarit për të moshuar në Shqipëri

Në bashkëpunim me Urdhrin e Infermierit dhe me mbështetjen e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, GIZ-ja është duke punuar, që profesioni i kujdestarit për të moshuar të bëhet pjesë e Urdhrit të Infermierit. Në rast se kjo do të realizohej, atëherë ky do të ishte një hap i madh drejt një profesioni të rregulluar.

Pranimi i “kujdestarit për të moshuar” si profesion nën mbikqyrjen e Urdhrit të Infermierit do të kishte këto avantazhe: personeli kujdestar që do të emërohej në institucionet shtetërore apo private kujdestarisë do të duhej të përmbushte kriteret minimale në lidhje me kualifikimet profesionale; Urdhëri do të lëshonte një licencë për kujdestarët për të moshuar dhe në këtë mënyrë do të mbikëqyrte dhe kontrollonte veprimtarinë e këtij personeli. Krahas kësaj, në një periudhë afatmesme, do të merrej në konsideratë edhe trajnimi profesional i personelit ekzistues në institucionet e të moshuarve.

Rregullimi i këtij profesioni do të ishte një arritje e madhe në rrugën drejt një sistemi të rregulluar dhe cilësor të kujdestarisë në Shqipëri.

Rëndësia e Kongresit kombëtar për Kujdestarinë për Moshën e Tretë, datë 26.11.2014, në Tiranë

Kongresi kombëtar për Kujdestarinë për Moshën e Tretë u mbajt në kohën e duhur. Ai kishte funksionet në vijim:

- ai sensibilizoi, se kujdestaria për të moshuarit do të jetë një temë qendrore e shoqërisë shqiptare në të ardhmen dhe se është e rëndësishme që në të ardhmen e afërt në Shqipëri të krijohet një sistem kujdestarie në përputhje me nevojat dhe i qëndrueshëm,
- ai kontribuoi në krijimin e vetëdijes, se personat që punojnë në institucione kujdestarie duhet të trajnohen për punën që bëjnë me të moshuarit. Ky trajnim duhet të jetë sa më praktik dhe jo akademik,
- ai theksoi rëndësinë, se profesioni i kujdestarit për të moshuar duhet të jetë një profesion i rregulluar, dhe
- duhet të krijohet një platformë e re kombëtare për të gjithë aktorët, të cilët punojnë në sektorin e kujdestarisë për të moshuar apo në kujdestari.

Shumë i rëndësishëm ishte fakti, që kongresi i dha një shtysë themelimit të Shoqatës së Kujdestarëve për Moshën e Tretë. Një shoqatë e tillë mund të bëjë lobim për profesionin e kujdestarit dhe të kontribuojë që ky profesion të njihet dhe të vlerësohet. Si përfaqësues i interesave përballë vendimmarrësve shoqata mund të japë impulse të rëndësishme, që “kujdestari për të moshuar” të njihet si profesion i rregulluar. Në një periudhë afatgjatë kujdestaria për të moshuarit duhet të ofrohet vetëm nga specialistë, të cilët kanë një shkollim të tillë.

Një falënderim i veçantë shkon për Fondacionin Friedrich Ebert dhe Sanus, të cilët morën iniciativën për të organizuar një aktivitet të tillë.



Bundesgeschäftsstelle

Postfach 1366

51657 Wiehl

Tel.: 02262-99999 14

Fax: 02262-999 99 16

Internet: www.dbva.de

eMail: info@dbva.de

Letër përshëndetëse e DBVA

Shoqata Gjermane për Kujdesin
ndaj Moshës së Tretë e.V.

DBVA e.V., Postfach 1366, 51657 Wiehl

Frank Hantke

Zyra Tiranë

Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 3

Tiranë/Shqipëri

Shumë të nderuar zonja dhe zotërinj,

të dashur kolege dhe kolegë,

Ftesën Tuaj për pjesëmarrjen në Kongres e pritëm me kënaqësi dhe shumë interes! Na vjen shumë keq, që nuk jemi në gjendje të dërgojmë një përfaqësi të Shoqatës Gjermane të Kujdesit për Moshën e Tretë tek Ju, sepse për fat të keq në të njëjtën periudhë ne kemi planifikuar organizimin e një aktiviteti të rëndësishëm.

Për fat të keq kujdesi për moshën e tretë vazhdon të trajtohet nga politika sociale si një fëmijë i gjetur, si në Shqipëri ashtu edhe në Gjermani. Popullsia në dy vendet tona është në plakje e sipër dhe për fat të mirë jetëgjatësia është rritur edhe tek Ju. Këtij fakti i shtohen edhe ndryshimet shoqërore, të cilat shpesh bëjnë, që familjet të mos kujdesen për të moshuarit. Por për çdo shoqëri del si detyrë parësore që të bëjë kujdes, që të moshuarit të mos lihen në mëshirën e fatit. Sepse ata kanë punuar gjithë jetën e tyre dhe kanë kontribuar për përparimin e vendit. Për këtë arsye, një detyrë parësore e politikës sociale duhet të jetë ofrimi i një pleqërie të denjë për të gjithë të moshuarit – pavarësisht nga pasuria që zotërojnë.

Krahas shtëpive të të moshuarve, të kompletuara ashtu siç duhet, në fokus qëndron edhe trajnimi i kualifikuar i kujdestarëve.

Kujdesi për të moshuarit është i vështirë, shpesh shumë i vështirë se kujdesi në sektorë të tjerë. Ne të gjithë e dimë, se ajo çka bëjmë çdo ditë është po aq lodhshme, sa edhe ofron kënaqësi dhe kërkon kompetenca të veçanta në shumë fusha. Për këtë arsye DBVA e përshëndet iniciativën Tuaj për njohjen dhe vlerësimin e profesionit të kujdestarit për moshën e tretë dhe në këtë mënyrë për një trajnim të kualifikuar në rrafsh të ndryshme! Shumë rëndësi ka këtu mësimi praktik – mënyra e sjelljes me të moshuarit nuk mund të mësohet në libra.

Në datën 1 dhjetor ne do të festojmë 40-vjetorin e themelimit të shoqatës sonë. Ne e dimë, se sa e rëndësishme është, që interesat tona si kujdestarë për moshën e tretë të përfaqësohen në mënyrë ambicioze dhe me një zë të vetëm, dhe që ne të angazhohemi me një zë të vetëm. Prandaj ne e përshëndesim shumë iniciativën Tuaj për të themeluar në vendin Tuaj një shoqatë

për përfaqësimin e interesave të kujdestarisë për moshën e tretë! Shpresojmë që t'ia dilni mbanë, që të siguron mbështetjen e të gjithëve.

Të dashur kolege dhe kolegë, të jeni të sigurt, se ne në të ardhmen do të bashkëpunojmë me kënaqësi me Ju dhe me shoqatën Tuaj të re. Ne Ju urojmë një mbarëvajtje interesante dhe të suksesshme të konferencës Suaj kaq të rëndësishme!

Përshëndetje miqësore



Christina Kaleve

Presidente e DBVA e.V.

AXHENDË

Kongresi Kombëtar 2014 për Përkujdesjen ndaj Moshës së Tretë

Data:	26. Nëntor, ora 09.00 – 16.00
Vendi:	Hotel Tirana International
Pjesëmarrësit	Përfaqësues të fushës së përkujdesjes ndaj moshës së tretë nga Shqipëria, eksperte të fushës së përkujdesjes ndaj moshës së tretë

Qëllimet/objektivat e Kongresit:

- ⇒ **Takim/mbledhje kombëtar i aktorëve të rëndësishëm në fushën e përkujdesjes ndaj moshës së tretë për shkëmbim përvojash/eksperiencash dhe idesh për punën e përbashkët në të ardhmen** (për këtë edhe një ekspozitë me prezantime/ broshura të pjesëmarrësve)
- ⇒ **Krijimi i një rrjeti informacioni dhe diskutim mbi formimin e një grupi pune për të themeluar një grup interesi “Shoqatën Shqiptare të Përkujdesjes ndaj Moshës së Tretë”**
- ⇒ **Qartësimi i nevojës për njohjen e profesionit të përkujdesjes ndaj moshës së tretë me një kualifikim të përshtatshëm, të njehsuar dhe me orientim dual në nivele të ndryshme në fushën jo-akademike dhe në atë akademike**
- ⇒ **Paraqitja/prezantimi i mundësive për të stabilizuar dhe zgjeruar përkujdesjen ndaj moshës së tretë**
- ⇒ **Bashkëpunim me organizata ndërkombëtare partnere**
- ⇒ **Prezantimi i një memorandumi të Kongresit**

Programi

09.00	Pritja dhe Regjitrimi i pjesëmarrësve
10.00	Mirëpritja: • Bardhylka Kospiri, Zv. Ministre e Mireqënies Sociale dhe Rinisë • Kosta Barjaba, Këshilltar i Ministrit të Shëndetësisë • Sabine Hartig, GIZ • Frank Hantke, Drejtor i FES-Tirana • Leter pershendetese nga Christina Kaleve, Kryetare e Shoqatës Gjermane të Profesioneve për Përkujdesjen e Moshës së Tretë (DBVA),
10.30	• Gezim Tushi, Shërbimi Social Shtetëror „Mbi situatën e përkujdesjes ndaj moshës së tretë në Shqipëri“
11.00	Diskutim i moderuar mbi prezantimin me ekspertet dhe pjesëmarrësit Moderator: Skender Dule, Kryetar i SANUS
12.00	Pushim dreke dhe takim në „Tregu i Mundësive“ (Ekspozite e aktiviteteve)
13.30	• Ardian Hackaj, Drejtor i Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI) “Zhvillimi i përkujdesjes ndaj moshës së tretë në avantazh krahasues: Shqipëria në tregun e Evropës Perëndimore”
13.50	• Skender Dule, Kryetar i SANUS Idetë aktuale për zhvillimin e mëtejshëm të fushës së përkujdesjes ndaj moshës së tretë në Shqipëri, prezantimi i një memorandum
14.10	Diskutim i moderuar mbi prezantimin me ekspertët dhe pjesëmarrësit Moderator: Skender Dule, Kryetar i SANUS
15.00	Dorëzim i memorandumit përfaqësuesve të qeverisë
15.15	• Frank Hantke, Drejtor i FES-Tirana Komente përmbyllëse
15.30	Mbyllja e kongresit me një koktej në „Tregun e Mundësive“


Situata aktuale e përkujdesjes ndaj moshës së tretë në Shqipëri

Elena Pici

Koordinatorë Programesh

Fondacioni Friedrich Ebert

Zyra e Tiranës



Prezbatim

Shqipëria po fillon të përballet me fenomenin e moshimit dhe plakjes së popullsisë, shkaktuar nga dy faktorë kryesorë: zgjatja e jetës mesatare dhe zvogëlimi i numrit të lindjeve. Ky ishte argumenti parësor me të cilin nisi prezantimin e tij Z. Gëzim Tushi, përfaqësues i Shërbimit Social Shtetëror. Tregues me shifra si: rritja e jetëgjatësisë mesatare nga 51.6 vjeç në 1950 në 77 vjeç në 2008; zvogëlimi i numrit të lindjeve nga 38,5 për 1000 banorë në 1950 në 9.1 për 1000 banorë në 2014; shtimi i popullsisë mbi 65 vjeç nga 5.3% në 1983 në 11.4% në 2011, mbështesin më së mirë argumentin e Z. Tushi. E megjithatë, në krahasim me vendet e zhvilluara ku popullsia e plakur përben 22.4% , në Shqipëri kjo shifër është vetëm 13.7%, duke na bërë të konsiderohemi një popullsi ende e re.

Ky pasqyrim i situatës aktuale në lidhje me plakjen e popullsisë, i shton rëndësinë diskutimeve që duhet të zhvillohen në kuadër të përmirësimit të shërbimeve për të moshuarit dhe të respektimit të të drejtave të tyre. Nga ana tjetër merr edhe një vëmendje të veçantë transformimi i familjes tradicionale e gerontokratike në familjen moderne (bërthamore si strukturë), të demokratizuar nga pikëpamja moshore, si dhe tendenca aktuale e krijimit të një shoqërie që duket se favorizon të rinjtë.

Kur diskutojmë rreth skemës së mbrojtjes sociale në Shqipëri, ajo është e bazuar në dy shtylla kryesore: Përfitimet kontributive (të përbëra nga pensionet dhe kujdesi shëndetësor) dhe Përfitimet jokontributive (përbërë nga skemat dhe institucionet e përkujdesit social për të moshuarit të nevojë). Bazuar në këtë ndarje, në Shqipëri ka aktualisht 6 Institucione Publike në: Tiranë, Kavajë, Shkodër, Fier, Gjirokastrë dhe Poliçan, në të cilat trajtohet rezidencialisht rreth 300 të moshuar. Megjithatë, vetëm Shtëpitë e të moshuarve në Tiranë dhe Poliçan janë nacionale, ndërkohë që pjesa tjetër kanë kaluar në administrim të pushtetit vendor. Kurse në lidhje me Shërbime Ditore Publike në administrim nga pushteti vendor ato janë vetëm 2, në Sarandë dhe Tiranë, ku trajtohen 90 të moshuar.

Edhe ky sektorë si shumë të tjerë, në vitet e fundit po pasurohet gjithnjë e më shumë me shërbyesit jo publik. Në Shqipëri sot janë 16 Institucione jopublike të përkujdesit për të moshuar

, nder te cilat vetëm katër janë qendra private qe ofrojnë shërbim kundrejt pagesës. Ne tërësi janë rreth 1400 të moshuar që trajtohen në strukturat publike dhe jopublike në Shqipëri.

Në përfundim, në të gjithë këtv situatë plakjeje të popullsisë, një rëndësi të veçantë ka kultura e moshimit. Duhet pranuar se tëqënurit plak apo pensionist padyshim nënkuptojnë jo të njëjtin stad jete. Kufijtë e moshës 65-74 vjeç duhet te nënkuptojnë një te moshuar te ri, nga 74- 84 vjeç një te moshuar dhe vetëm mbi këtë moshë një të moshuar të plakur. Të moshuarit duhet te vazhdojnë të kenë një kontribut social vullnetar, kjo si mënyre për dinamizimi e jetës se tyre, por edhe për pasurimin e roleve dhe kontributeve në shoqëri.

Diskutim

Sigurisht që për të trajtuar problematikat diverse në këndvështrime të ndryshme nuk do të mjaftonte një ditë diskutimesh, por mirëkuptimi i treguar nga të gjithë pjesëmarrësit ishte një avantazh i madh për të qenë sa me konkret dhe për të konkluduar në vendime shumë të rëndësishme për vazhdimësinë në të ardhmen.

Pas një analize të hollësishme të situatës aktuale të kujdesit ndaj të moshuarve nga Prof. Gëzim Tushi, në vijim u përmenden disa nga përvojat dhe problemet që prezantuan dhe u diskutuan nën moderimin e kryetarit të shoqatës “SANUS Infermieri Ambulante” Z. Skënder Dule.

Nëse flasim për një përkujdesje bashkëkohore për të moshuar nuk mund ta mendojmë pa një mjekësi geriatriketë zhvilluar dhe më mirë se askush tjetër këtë mungesë të theksuar në specialitetet mjekësore në Shqipëri mund ta trajtonte vetëm se Dr. Kiri Zallari kryetar i Shoqatës “Për nxitjen dhe zhvillimin e Geriatriisë”, sipas të cilit - përpjekjet e deritanishme kanë qenë tepër sporadike, të shkëputura në kohë dhe për këtë arsye nuk kanë patur jetëgjatësi por as inpaktin e duhur në këtë grupmoshë dhe as në shoqëri. Njëkohësisht, ai përmendi nevojën e stafit mjekësor te kualifikuar dhe mungesen e pergjithshme qe ka ne vend per mjeket per moshen e trete.

Z. Ismail Kadiu drejtor i shtëpisë për të moshuar Kavajë me tepër realizëm solli problematikat e një shtëpie shtetërore për te moshuar, duke filluar me diversitetin e historive sociale dhe patologjive që kanë të moshuarit që banojnë aty si psh. të braktisur, të paralizuar, të verbër, me Demeze, Alzheimer etj., të cilet kërkojnë një përkujdesje të specializuar specifike e cila është shumë e vështirë të realizohet në një tipologji unike të ofrimit të shërbimit. Pjese e ekipi multidisiplinar janë dhe infermierët të cilët shpesh herë nuk përballojnë dot nevojat specifike për përkujdesje ndaj të moshuarve, edhe për shkak te mungesës së kualifikimit profesional te tyre (e cila ndikon ndjeshëm ne uljen e cilësisë së shërbimit te ofruar), edhe për shkak te infrastrukturës se pamjaftueshme

Ofruesit privat të kujdesit për të moshuar përballen çdo ditë me vështirësitë e tregut akoma të pa njohur të këtij biznesi social. Këtë problematikë e sjell në kongres drejtuesja e biznesit social multifunksional të ri “Shtëpia e Zotërinjeve” Daklea Shtylla sipas së cilës është e domosdoshme ndërtimi i një bashkëpunimi të formalizuar për të stimuluar hapjen dhe lehtësimi e proceduarave për bizneseve e reja në këtë fushë.

Ndërsa Lumturi Abazi, drejtoresha e qendrës polivalente në Kamëz, sjell eksperiencat disa vjecare të saj në drejtimin e kësaj qendër. Ajo thekson domosdoshmërinë e ndërgjegjësimin të shoqërisë për të kontribuar dhe bashkëpunuar për funksionimin normal të këtyre qendrave duke mos ngarkuar tashmë me përgjegjësi vetëm shtetin. Njëkohësisht ajo foli rreth bashkëpunimit të tyre të suksesshëm me studentet e departamentit të kujdestarisë, të Shkolles Profesionale Kamez. Keta studente nuk e shohin qendrën vetëm si mundësi për praktikimin e aftësive të tyre, por dhe për të kontribuar në mirëmbajtjen e qendrës dhe për të përfituar sa më shumë nga eksperiencat jetësore të të moshuarve gjatë aktiviteteve të përbashkëta.

Një problematikë shumë e mprehtë u diskutua nga Presidenti i UISH (Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë) Z. Sabri Skënderi, i cili shprehu gatishmërinë e tij për përmirësime ligjore me qëllim përfshirjen e profesionit të Kujdestarit për të Moshuar në urdhrin profesional që ai drejton, me qëllim formalizimin e këtij specialitetin në profesionet e rregulluara me ligj.

Sipas mendimit të specialistes në sektorin e hartimit të kurikulave në AKFAP (Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional) Znj. Marsela Robo, ekziston tashmë prej vitit akademik 2009-2010 një plan mësimor i miratuar për profesionin e Kujdestarit për të Moshuar, profesion i cili evidentohet dukshëm me Nr 5131 në listën ndërkombëtare të profesioneve. Por sigurisht si për çdo plan mësimor janë gjithnjë të nevojshme përmirësime të herë pas herëshme.

Për rëndësinë e rehabilitimit fizik të të moshuarve në kontekstin e ruajtjes sa më gjatë të jetë e mundur të pavarësisë dhe mobilitetit të tyre u shpreh me profesionalizëm Z. Erion Hiluku president i Shoqatës Shqiptare së Fizioterapistëve. Sipas tij mungojnë në tregun e përkujdesjes qëndra të tilla rehabilitimi sidomos për trajtime postrumatike, postoperative dhe neurologjike të cilat janë disa nga problemet më kryesore që prekin rrezikshëm këtë grupmoshe. Z. Hiluku solli në vëmendje mungesën e pranisë së fizioterapistëve në shërbimin që i ofrohet moshës së tretë. Në shtetet perëndimore ky raport fillon duke qenë se paku 1/50 (një fizioterapist për 50 të moshuar), ndërsa në Shqipëri jemi larg këtij standardi.

Shtëpinë e të moshuarve “Duaje Moshën” e përfaqësoi punonjësja social Znj. Anduena Karapici, sipas së cilës ekipit multidisiplinar i mungon një nga elementet më të rëndësishme të tij, siç është ai i kujdestarit për të moshuar, të cilin shpesh e sipërmarrin persona të paarsimuar dhe të pakualifikuar për këtë profesion të rëndësishëm.

Shumë i veçantë në këtë kongres ishte dhe diskutimi i kryetarit të Uniteti Kombëtar të Pensionistëve të Shqipërisë Z. Skënder Kameniku, i cili duke sjellë eksperiencën e një qendre komunitare në vështirësi ekonomike, theksoi rëndësinë e vullnetarizmit social dhe angazhimit të vetë të moshuarve për të bërë jetën e tyre sa më aktive por dhe për të transmetuar përvojat e tyre personale dhe profesionale tek brezat që vijnë.

Për realitetin e përditshëm të përkujdesjes për të moshuarit në qytetet e vogla pothuajse të harruara si Burreli, diskutoi Dr. Dalip Gjoka i cili drejton e Qendrën Ditore të Moshuarve Mati, e cila funksionon pothuajse me kontributin personal të tij dhe të njerëzve që japin aq sa munden nga vetja e tyre.

Një këndvështrim i rëndësishëm ishte ai i maturantit të Shkollës së mesme profesionale Kamëz, dega “Kujdestari për të Moshuar”, Kleo Tervoli. Sipas tij kompetencat e përgjithshme,

personale dhe profesionale të fituara nëpërmjet koordinimi të mësimave teorike dhe praktike në shkollë me praktikën profesionale jashtë shkollës, në Qendra për të Moshuar, janë plotësisht të mjaftueshme për të sipërmarrë përkujdesjen për të moshuar si në rezidenca por dhe në ambientin jetësor të shtëpisë. Mbresëlënëse ishin fjalët, “ Na provoni”, të maturantes Blerta Laci.

Gjatë pushimit të drekës dhe fazës së shoqërizimi, pjesëmarrësit të shpërndarë në grupe të ndryshme, diskutuan problemet e përbashkëta me njëri-tjetrin”, shkëmbyen eksperiencat dhe idetë e tyre për bashkëpunime në të ardhmen. Nga shoqata “SANUS Infermieri Ambulante” u promovua dhe u shpërnda Libri “ Infermiera Sociale” dhe broshuara “Për një Plegëri të Mbarë” të autorëve Albana dhe Skënder Dule, duke diskutuar për problematikat që përballen përkujdesja për të moshuar në banesë si p.sh pamundësia e pagesë së shërbimeve nga të moshuarit, braktisja, vetmia etj.

Rekomandime

- Decentralizimi i shërbimit social, duke theksuar rolin e pushtetit lokal. Në këtë mënyrë do të përmirësohet struktura dhe do të plotësohet Harta e Institucioneve të Përkujdesit në “Zonat e Bardha” ku nuk ka shërbime për të moshuar
- Lobimi për njohjen, vlerësimin si të domosdoshëm në çdo institucion përkujdesjeje dhe kualifikimin e mëtijshëm të profesionit të kujdestarit, i cili është i veçantë dhe i ndryshëm nga profesioni i infermierit
- Ofrimi i shërbimeve alternative, deri në shërbimin e personalizuar në shtëpi, si antidot kundër rezidencializmit
- Demokratizimi i shërbimit për të moshuarit – Përfituesit kanë të drejtën e zgjedhjes së shërbimit sipas mundësisë. Në këtë rast, shërbimi i përkujdesjes në formën e një biznesi social do të ishte pararendës
- Shërbimi në institucionet bëhet me standarde, të cilat duhen inspektuar dhe monitoruar nga enti rregullator përkatës
- Përmirësimi i shërbimit në institucionet e përkujdesit – Ofrimi i ekipeve multidisciplinare; përmirësimi i higjienës; larmishmëria e kuotës ushqimore; dhe rritja e masës së pjesës së pensionit për përdorim vetjak.
- Forcimi i lidhjeve mes të moshuarve dhe komunitetit të jetës sociale


Shqipëria si ofruese e shërbimit të përkujdesjes ndaj moshës së tretë

Elena Pici

Koordinatorë Programesh

Fondacioni Friedrich Ebert

Zyra e Tiranës



Prezbatim

Aktualisht ka më shumë se 120 milion pensionistë në të gjithë Bashkimin Evropian. Në një situatë ekonomike me zhvillim të ulët, papunësi të lartë, me më pak fuqi punëtore aktive dhe me më shumë pensionistë (rezultat i plakjes së popullsisë), kostoja e skemës së pensioneve dhe shërbimit social do të vazhdojë të jetë një zë në rritje në buxhetin e Bashkimit Evropian.

Z. Ardian Hackaj, drejtues i Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim, shtoi elemente të tjera statistikore në prezantimin e tij. Rezulton se në vendet e Bashkimit Evropian përqindja e popullsisë mbi 65 vjeç është rritur nga 17% në 30 %, ndërsa ajo e popullsisë mbi 80 vjeç nga 5% në 12 %. Në këtë situatë shpenzimet për frymë për këtë kategori të popullsisë po rriten ndjeshëm. Po ti shtojmë dhe rolin gjithnjë e më të pakët që luajnë familjet në suportimin e të moshuarve, do të ketë vazhdimisht më shumë të moshuar – në gjendje të mirë ose jo shëndetësore- që do të jenë të paaftë të plotësojnë nevojat e tyre moshore për shkak të mundësive financiare të limituara. Si rrjedhim, të moshuarit e vendeve perëndimore do të zhvendosen për ta marr shërbimin e përkujdesjes në vende ku ai ofrohet me një kosto më të ulët.

Z. Hackaj beson se në këtë situatë Shqipëria ka disa avantazhe krahasuese për të ofruar cilësisht këtë lloj shërbimi:

- **Strategjia e Kostove** – ofrimi një shërbimi që plotëson standardet kryesore Evropiane, por që vjen me një kosto konsiderueshëm më të ulët. Shqipëria mundëson kosto më të ulëta për ndërtim/infrastruktura, kosto më të ulëta në paga, kosto më të ulëta në ushqim dhe shërbime shtesë.
- **Strategjia e Diversifikimit** – ofrimi i një shumëllojshmërie aktivitesh dhe shërbimesh, të cilat kompetitorët e kanë të pamundur t'i ofrojnë (psh. Aktivitet në natyrë, vizita periodike në vendet e rajonit etj) Avantazhi i të pasurit gati 260 dite me diell në vit, përben një mundësi të shkëlqyer për aktivitetet në natyrë.

Megjithatë, reputacioni i ulët që ka Shqipëria në ofrimin e këtij lloj shërbimi dhe mungesa e

profesionisteve në geriatri, sjell nevojën e një pune të madhe përgatitore dhe bashkëpunuese për ta pozicionuar Shqipërinë si një ofruese kryesore e shërbimit.

Diskutim

Pas prezantimit të Z. Hackaj, dhe pikë-vështimit të tij se Shqipëria mund të jetë jo vetëm një vend pushimesh, por një qendër rezidenciale për të moshuar, sigurisht sipas standardeve europiane, e ilustroi këtë ide edhe moderatori i diskutimeve Z. Skënder Dule, me përpjekjet e shoqatës që ai drejton për të sjellë pushues të moshuar gjerman në Shqipëri për vet avantazhet që ofron Shqipëria.

Në fazën e dytë pas leximit dhe komentimit të momerandumit, i cili ju dorëzua zëvendësministres së MMSR Znj. Bardhylka Kospiri, i gjithë diskutimi i pjesëmarrësve u fokusua në unifikim në një zë të përbashkët për të gjetur dhe për të dhënë zgjidhje të mundshme problematikave në fushë e kujdesit për të moshuar si dhe këtij profesioni të munguar në tregun e shërbimeve sociale.

Unanim ishte mendimi i të gjithë pjesëmarrësve për thirrjen sa më të shpejte të një grupi pune, i cili do të hartojë dokumentacionin dhe do të përgatisë kushtet për themelimin e “Shoqatës Kombëtar të kujdesit për të Moshuar”, ngjarje kjo që mbylli Kongresin e Parë Kombëtar “Përkujdesja ndaj Moshës së Tretë”.

Konkluzione

Skënder Dule

Kryetar i Shoqatës “SANUS Infermieri Ambulante”



Kongresi kombëtar “Përkujdesja ndaj Moshës së Tretë” ishte një nga aktivitetet e veçanta të organizuara rrallëherë në vendin tonë në fushën e përkujdesjes për të moshuar.

I veçantë jo vetëm për nga niveli shkencor dhe akademik që përligj thirja dhe organizimi i një kongresi, por edhe për shkallën e lartë të vërtetësisë së trajtimit të problematikave që përballet sot shoqëria shqiptare, ashtu si dhe vendet e zhvilluara në fushën e përkujdesjes për të moshuar.

I veçantë sepse pjesëmarrja e aktorëve të kësaj fushe që kujtohet vetëm në datën 1 Tetor në Ditën Ndërkombëtare të të Moshuarve, ishte gjithëpërfshirës, për nga diversiteti i institucioneve dhe organizatave pjesëmarrëse, por dhe nga shtrirja gjeografike prej nga vinin pjesëmarrësit në këtë kongres.

Mjafton të përmendim përfaqësuesit e MMSR, MSH, SHSSH, AKAFP, Universiteteve, Bizneseve, Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social, Qendrave Spitalore Universitare, Qendrave dhe Shtëpive për të Moshuar, Shkollave Profesionale, Urdhri të Infermierit të Shqipërisë, Fondacione Ndërkombëtare, Organizatave të Shoqërisë Civile të fokusuara në përkujdesjen për të moshuar, Shoqatave të pensionistëve si dhe student, nxënës etj.

Janë me të vërtetë për tu përgëzuar të gjithë pjesëmarrësit jo vetëm që ju përgjigjën me vullnet të lirë thirrjes së kongresit, por që kontribuan me profesionalizëm duke qenë shumë aktiv me diskutimet e tyre në të gjitha seancat e këtij kongresi.

Një kongres i veçantë që nuk filloi si zakonisht me zhurmën e kameramanëve dhe të gazetarëve të shumtë të stacioneve televizive por me thjeshtësinë e modestinë e këtyre profesionistëve kokëulur dhe të papërtuar të cilët gëzoheshin pamasë që në këtë kongres mund të ishin në fund së bashku për të diskutuar për problemet, me mirë të themi për të qarë hallet, me të cilat ata përballen në çdo ditë të jetës së tyre personale dhe profesionale.

I veçantë për nga konceptimi jo vetëm si një Kongres, por si “Treg Mundësish” i promovuar me thjeshtësi por me shumë profesionalizëm nëpërmjet posterave, fletëpalosjeve, broshurave, librave profesional për të cilën ishte në dispozicion një kohë e mjaftueshme shoqërimi ndërmjet

përfaqësuesve të rreth 50 organizatave pjesëmarrëse.

Në Kongresin e parë Kombëtar “Përkujdesja ndaj moshës së tretë” cili u organizua në datë 26.11.2014, mundësuar nga fondacioni Friedrich Ebert FES në bashkëpunim me shoqatën “SANUS Infermieri Ambulante” dhe kompaninë gjermane GIZ u u konkludua me zgjidhje dhe hapa konkret për të ardhmen e mirëqenies sociale të ndërthurur pazgjidhshmërisht me atë shëndetësore të një grupmoshe të rëndësishme të shoqërisë.

Konkluzionet dhe hapat e rëndësishëm për të ardhmen si më poshtë vijon:

1. Përfaqësim kombëtar i interesave të përbashkëta në fushën e përkujdesjes për të moshuar.

Unifikim i një vokacioni të përbashkët të të gjithë aktorëve dhe faktorëve aktiv në fushën e kujdesit për të moshuar në Shqipëri në një OJF (Organizatë jofitimprurse) të vetme pra në një shoqatë profesionale ombrellë të fokusuar në përkujdesjen e të moshuarve dhe e përbërë nga persona fizikë ashtu dhe juridike në përputhje të plotë me rregullat demokratike dhe legjisllacionin shqiptar.

Shoqata kombëtare do të:

- përfaqësojë interesat individuale të anëtarëve dhe organizatave të saj anëtare në institucionet publike përkatës në një demokraci moderne dhe aktive.
- ofrojë politikës konsulencë shkencore dhe profesionale, kompetente në fushën e përkujdesjes për të moshuar.
- hamendësojë përmirësime dhe ndryshime ligjore në funksion të një përkujdesje social shëndetësore me standarde europiane në kuadër të një shërbimi multidisiplinar Geriatrik
- llobojë me të gjithë aktorët publik dhe privat kombëtar dhe ndërkombëtar të fushës për njohjen e profesionit të “Kujdestarit për të Moshuar” si profesion i rregulluar.
- bashkërendojë aktivitetet e përbashkëta ndërmjet anëtarëve të shoqatës por dhe me shoqata dhe organizata të tjera homologe kombëtare me qëllim klasifikimin e specifikimin e diversitetit të shërbimeve të ofruara.
- krijojë në Shqipëri një standard kujdestarie për të moshuar me perspektivë për të ardhmen.

2. Hapa konkret për vazhdimësinë

Për të realizuar dhe garantuar vazhdimësinë e përpjekjeve të gjithë të interesuarve janë planifikuar hapat konkrete si më poshtë vijon:

- Publikimi dhe promovimi në media Televizive i kongresit të parë kombëtar “Përkujdesja ndaj moshës së Tretë” si dhe njohja e sensibilizimi i publikut ndaj përkujdesjes për të moshuar.
- Hartimi, botimi i revistës së kongresit të parë kombëtar “Përkujdesja ndaj moshës së Tretë” në funksion të promovimit të rezultateve të arritur deri tani.

- Ngritja e grupit të punës i cili do të përgatisë dhe organizojë themelimin e shoqatës profesionale kombëtare ombrellë të kujdesit për të moshuar.
- Hartimi i Statutit dhe Programit të shoqatës profesionale kombëtare ombrellë të kujdesit për të moshuar.
- Thirrja e asamblesë kombëtare për themelimin e shoqatës profesionale kombëtare ombrellë të kujdesit për të moshuar.

I gjithë grupi organizativ, por besojmë se edhe pjesëmarrësit, janë besimplote ne jetëgjatësinë dhe suksesin e kësaj nisme, e cila me krijim e shoqatës së përbashkët do të mundësojë dhe thirrjen e përvitshme të një Kongresi të tillë produktiv.

Memorandum për përkujdesjen ndaj moshës së tretë

SI PARAQITET SITUATA SOT?

Numri i të moshuarve në Shqipëri është në rritje!

Në Shqipëri jetojnë rreth 100.000 të moshuar. Më shumë se 80% prej tyre jetojnë në shtëpi – shpesh pa përkujdesje të veçantë dhe në varfëri. Në fakt jetëgjatësia është në rritje, por nga ana tjetër konstatohet një numër i lartë i të sëmurëve kronikë si edhe i personave që kalojnë në depresion. Vetëm më pak se 10% e të moshuarve dhe pothuajse vetëm 5% e femrave të moshuara marrin pjesë aktive në shoqëri. Numri i të moshuarve në Shqipëri do të vazhdojë të rritet.

Situata aktuale e përkujdesjes nuk i përmbush kërkesat minimale për një pleqëri të denjë!

Në këtë situatë Shqipëria ofron në të gjithë territorin e saj një sistem përkujdesjeje, i cili u ofron rreth 500 të moshuarve një vend të përshtatshëm në shtëpitë e moshës së tretë. Krahas këtyre shtëpive ofrohen edhe disa institucione ditore. Kujdesi mbulohet nga kujdestarët, të cilët pjesërisht kanë formim profesional të ndryshëm dhe janë të bashkuar në 19 organizata të ndryshme joqeveritare.

Shoqëria dhe shteti duhet të krijojnë kushtet e nevojshme për një përkujdesje të mirë ndaj moshës së tretë

Shqipëria ka një shoqëri, e cila është duke ndryshuar dhe duke u modernizuar me shpejtësi. Familjet, për arsye të ndryshme, nuk janë në gjendje të garantojnë përkujdesjen për të afërmit e tyre të moshuar. Por një shoqëri duhet të jetë e vetëdijshme për përgjegjësinë që mban ndaj brezit të moshuar dhe duhet t'i garantojë atij një pleqëri të denjë. Kjo nuk mund të jetë një detyrë që duhet të mbulohet vetëm privatisht. Shteti duhet t'u krijojë qytetarëve të vet kushtet për marrjen e një përkujdesjeje të denjë në pleqëri.

ÇFARË ËSHTË E NEVOJSHME?

Profesioni i kujdestarit për moshën e tretë duhet të njihet!

Në fakt – në nivele të ndryshme – ekzistojnë degë mësimore dhe universitare për përkujdesjen ndaj moshës së tretë, por profesioni i kujdestarit për moshën e tretë ende nuk njihet në një segment në rritje. Por ky është një parakusht i domosdoshëm për të vënë në lëvizje më shumë të rinj që t'i përkushtohen këtij profesioni, shpesh të vështirë. Njohja e profesionit të kujdestarit për moshën e tretë si një profesion i rregullt i hap rrugë edhe një arsimit dhe formimit profesional të njësuar, modern dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Ne kemi nevojë për një trajnim profesional të kujdestarëve për të moshuar, të orientuar drejt praktikës dhe së ardhmes!

Trajnimi i kujdestarëve për të moshuar, i orientuar drejt së ardhmes, duhet të orientohet në domosdoshmëritë për një përkujdesje dhe trajtim të plotë ndaj të moshuarve. Kjo fillon nga veprimtaritë e thjeshta të kujdestarisë dhe arrin deri tek mjekësia geriatrike. Kurrikula për degët mësimore duhet të përmbajë një ndërthurje të domosdoshme të teorisë me praktikën. Për këtë qëllim duhet të krijohen kushtet në shkollat profesionale dhe në shkollat e larta në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

Situata e kujdestarisë dhe e shtëpive të të moshuarve duhet të përmirësohet shpejt dhe rrënjësisht!

Situata e shtëpive ditore dhe e shtëpive të të moshuarve duhet të përmirësohet shpejt. Kjo vlen si për sasinë ashtu edhe për cilësinë e institucioneve. Për këtë qëllim nevojitet mbështetje financiare nga shteti. Krahas kësaj duhet menduar për të krijuar një sigurim specifik për kujdestarinë, në mënyrë që edhe njerëzit më të dobët të mund të trajtohen me dinjitet. Për këtë nevojitet nxitja e studimeve mbi nevojat dhe kushtet më të përshtatshme për vendndodhjet.

KY ËSHTË SYNIMI YNË!

Nevojitet një përfaqësim kombëtar i interesave!

Kushtet e deritanishme të arsimit profesional dhe kushtet e punës për kujdestarët për të moshuar nuk përputhen aspak me standardet – sigurisht aspak në këndvështrim të integritetit në BE. Për këtë qëllim duhet që interesat e të gjithë të punësuarve në sektorin e kujdestarisë të përfaqësohen në të ardhmen nga një shoqatë ombrellë „Kujdestaria për moshën e tretë në Shqipëri“. Pjesëtarë të kësaj shoqate mund të jenë të gjithë të punësuarit në sektorin e kujdestarisë për moshën e tretë si edhe organizatat e tyre përkatëse. Shoqata ombrellë duhet të krijohet dhe drejtohet në përputhje të plotë me rregullat demokratike. Për ta garantuar këtë duhet të krijohet një grup pune me përfaqësues nga kujdestarët për moshën e tretë, i cili do të merret me hartimin e statutit të shoqatës.

Në të ardhmen ne synojmë të bashkëveprojmë aktivisht për krijimin në Shqipëri të një kujdestarie për moshën e tretë, e cila është e orientuar drejt së ardhmes!

Shoqata ombrellë „Kujdestaria për moshën e tretë në Shqipëri“ është një përfaqësim demokratik i interesave dhe i vendos vetes si detyrë, që t’i ofrojë politikës konsulencë profesionale dhe kompetente në fushën e kujdestarisë për moshën e tretë. Në të njëjtën mënyrë shoqata ombrellë do të përfaqësojë interesat individuale të anëtarëve dhe organizatave të saj anëtare. Në këtë mënyrë shoqata ombrellë do të marrë përsipër rolin e përfaqësimit të nevojshëm të interesave në një demokraci moderne dhe aktive.







